

## Policia politike e Kryeministrit

[Gazeta Shqiptare, 14.3.2006]

Nuk po i ecën aq kollaj nënshtrimi, futja nën varsi direkt e institucioneve që sipas Kushtetutës nuk duhet të varen fare nga ai, nga kryeministri aktual. Duket se në këto kushte, u është drejtuar mesimeve të Blitzkrieg (të luftës rrufe) të Hitlerit: “mos humb kohë duke ngecur me nënshtrimin e ishujve të veçantë të qëndresës, por ec përpara në okupimin e vendit, duke izoluar e anashkaluar ata ishuj”. Kështu po synohet të anashkalohej prokuroria, dhe shumë organe të tjera, duke krijuar, me këtë projektligjin “Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit”, një “polici politike” (PP) të kryeministrit aktual të Shqipërisë.

Nuk ia vlen të komentohet nën për nën projektligji në fjalë, sepse ai është i mbushur me shkelje të kushtetutës, në çdo rresht të tij. **Shkelja kryesore qëndron, jo në mënyrën se si projektohet të bëhen denoncimet, apo pagesat e denoncuesve, por në menaxhimin e tyre nga një organizmëm i ri antikushtetues** (apo disa “institucione shtetërore”—neni 3), që **po e quajmë “policia politike e kryeministrit aktual”, që shkurt mund ta quajmë PP, në analogji me SS (SchutzStaffel) të nazizmit ose SSh (sigurimi i shtetit) të komunizmit**. Po anashkalohej dhe po izolohej organet kushtetuese, si prokuroria, SHISH, policia kriminale, gjykatat, e kompleksi i institucioneve që duhet të bashkëveprojnë në një shtet demokratik, duke ndaluar përqëndrimin e pushtetit në një institucion të vetëm, e jo më në një person të vetëm!. Praktikisht pritet që PP t’i zëvendësojë të gjithë këto organe, meqë do të jetë një organ lehtësisht i centralizueshëm (projekti udhëzon denoncim në “institucioni epror”—neni 4)—njihet mania e përqëndrimit të pushtetit në duart e veta, që ka demonstruar prej vitesh kryeministri ynë.

E janë dhënë të gjithë incentivat (nxitësit) materiale që denoncuesit të mblidhen si grenzat rreth mjaltit: u jepet një shpërblim bazë deri sa 80 paga mujore të një arsimtari, apo deri sa vlera e legalizimit të 5 parcelave tokë-shtëpi nga të informalëve (neni 14), e ky shpërblim është veçse njëra pjesë, se është edhe ajo llokma prej “6% të vlerës së përfitimit”: kryeministri nuk qenka fare në dietë, kur ardhka puna te ky “publiku denoncues” i PP-së—se mos paguan ai, ne, taksapaguesit, populli jemi që paguajmë!

Projektligji në fjalë, ka një konflikt doktrinal me demokracinë. Çdo shtet ka organet, institucionet e veta të ndjekjes dhe akuzës, ku kryesori është prokuroria. Ky organ është pranë sistemit gjyqësor, sipas Kushtetutës sonë. Bota i bën këto organe të ndara, duke respektuar ndarjen e pushteteve, dhe të kontrollueshme (principi i “checks and balances”), të dyja këto principe bazë e të domosdoshme të demokracisë. Kurse tani kërkohet fryrja e fshehtë e administratës shtetërore, me persona që do të bëjnë “hetime administrative” mbi bazën e denoncimeve të “personave që denoncojnë praktikën korruptive”, duke qenë pjesë e oktapodit gjigand, PP, që do të shtrihet në të gjithë administratën shtetërore. PP ka, brenda administratës, funksione të ndjekjes, akuzës e përse jo edhe të dënimit—përse të humbet kohë kot me burokracitë e prokurorive, provave, avokatëve, gjykatave etj.. Këto do të duan profesionistët përkatës, si juristë e policë, por që do të maskohen me titujt “shef i personelit”, “drejtor i administratës”, “furnitor”, “juristi”, “roje” etj. Këta të gjithë do të jenë dora e zgjatur e kryeministrit, gjoja gjithënjë për të mirën e popullit, si vaktit në kohën e komunizmit: “çdo partia bën populli, çdo populli bën partia”.

PP do të përdoret për të goditur kundërshtarët politikë—antikorrupsioni do të jetë vetëm dukja e jashtme: “praktikë korruptive”, sipas përcaktimit të projekt ligjit, është një thes i gjërë, që PP të mund të fusë ç’të dojë, si “neni 55” i kohës së komunizmit. Sa për të mbajtur anën formale, PP do të kalojë në prokurori e gjykatë, “ndonjë dosje të pjekur”, që t’i vërë vulën, të dënojë viktimën në “rrugë demokratike”—por kjo nuk është aq e ngutshme, sepse për t’u nxirrë

jetën “armiqve”, nuk ka nevojë për “ata të degjeneruarit e sistemit të drejtësisë”: bëjnë dhe pa ta, na lejon “neni 9, 12 etj.”, sa t’i futin në dorë edhe ato ishuj të izoluar të “këtij sistemi drejtësie që veç drejtësi nuk jep”.

Ka eksperiencia në krijimin e rrjeteve të tilla në botë, që me SS etj. të nazizmit, me SSh të komunizmit, etj. Por thuhet se paska edhe një eksperiencë të afërt fare: rrjeti që ekzistua kësh prej vitesh brenda në PD-në aktuale, ku në çdo qytet, çdo degë PD-je, paskësh “dy-tre vetë” që komunikuakan direkt me “mar’shallin” (pseudonimi i tyre përkëdhelës për kryeministrin aktual, sipas mareshalit Tito të Jugosllavisë). PP e PD-së komunikuaka me të, duke anashkaluar çdo lloj forumi—dhe ç’thënkuan ata u bëka! Bile tani nuk paska nevojë as të mblidhen as sa për formë, as seksionet, as kryesitë e PD-së, as aktivet: ato u dashkan sa për të marrë votat gjatë zgjedhjeve, pastaj komanduaka direkt rrjeti i PP i PD-së, pra i kryeministrit.

Në vitet e komunizmit, ishte sigurimi i shtetit (SSh) dhe partia, ata që luanin rolin e policisë politike. Sundimi i SSh në jetën e përditshme, parti-punë-familje, nuk u pat kundërshtuar nga vetë komunistët e kohës, dhe si rezultat ata e pësuan njësoj me të tjerët: u pushkatuan e u përndoqën për 40 vjet me radhë, deri sa natyra i ndërpreu jetën Enverit. Kështu ngjau dhe me shumë PD-istë të fillimit të viteve ’90, natyrisht jo me pushkatime fizike, por politike. Këtë leksion (mësim) duhet ta mësojnë mirë deputetët aktualë të PD-së, e mos të bëjnë gabimet e të parëve të tyre, por t’i kundërvihen të keqes që në lindje: të mos miratojnë në asnjë mënyrë atë ligj antikushetues, sepse edhe ata vetë “do ta hanë”: nuk dallon diktatura, komunist, antikomunist, demokrat, socialist, të gjithë janë njësoj, subjekte të shtypjes diktatoriale.

Bashkim Kopliku

Durrës, më 13.3.2006